



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORË

Nr. 267 Prot.(Xh.S)

Vlorë, më 14 /05/2020

Lënda: Dërgohet urdhëri i ekzekutimit të vendimit penal.

ZYRËS PËRMBARIMORE

V L O R Ë

DREJTORISË VENDORE TË AGJENSISË SHTETËRORE TË KADASTRËS

V L O R Ë

DHOMA E NOTERISË

Notere: Jetmira Veraj

V L O R Ë

GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË

V L O R Ë

Bashkëlidhur me këtë shkresë po ju dërgojmë urdhërin e prokurorit nr.188, datë 13/05/2020, për ekzekutimin e vendimit penal të formës së prerë nr.158, datë 27/01/2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe aktet bashkëngjitur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËS DREJTUESI I PROKURORISË

Albert KULIÇI

DREJTUESI I PROKURORISË

Erion ÇELA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË VLORË

URDHËR

Nr.188, datë 13/05/2020

**Për ekzekutimin e vendimit nr158, datë 27/01/2020
të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë**

Në Vlorë, viti 2020, muaji Maj, datë 13.

Unë Xhemal Saliaj, Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, pasi u njoha me përmbajtjen e vendimit penal nr158, datë 27/01/2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, dërguar me shkresën nr.2969, datë 06/03/2020, me kërkesë: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe objekt: Pushimi i procedimit penal nr.419/2018,

KONSTATOVA:

Se me vendimin penal nr158, datë 27/01/2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur:

1. Pushimin e çështjes penale nr.419/208, rregjistruar për veprat penale "Falsifikimi i dokumentave" dhe "Shpërdorim detyre", parashikuar nga nenet 186 dhe 248 të Kodit Penal.
2. Pasuria e paluajtshme me nr.13/8/1, vol.17, faqe 137, zk.8605, në emër të shtetasit Qirjako Lluka Gjikota, me sipërfaqje prej 2590 m², e vendosur nën masën e sigurimit pasuror "Sekuestro preventive" me vendimin me nr.481 datë 18/02/2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, të konfiskohet dhe të kalojë në favor të shtetit.
3. Të deklarohet falsiteti i dokumentave të sekuestruara gjatë hetimeve paraprake si: "Kartela e pasurisë së paluajtshme", me nr.pasurie 13/8/1, vol.17, faqe 137, zk.8605, në emër të shtetasit Qirjako Lluka Gjikota, "Vërtetim pronësie", Ipoteka Vlorë, më 01/04/1994, në emër të shtetasit Qirjako Gjikota, me nr.00005905, ZK.8605, në një fletë formati ½ a4, "Kontratë shitje" nr.14610.Rep, datë 22/03/1994, në një fletë formati A4, e cila në fund të fletës, ana e djathtë ka numrin 00005905, të cilat i janë bashkuar

fashikullit të këtij procedimi penal, duke urdhëruar ndalimin e qarkullimit të tyre dhe vendosjen e shenjës treguese “Dokument i falsifikuar”.

Vendimi penal nr.158, datë 27/01/2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka marrë formë të prerë në datën 09/03/2020, pasi nuk është ankimuar.

Për sa më sipër, bazuar në Nenin 462, Nenin 464, Nenin 465 dhe Nenin 486, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Penale, si dhe Nenin 12, Nenin 17, Nenin 22 dhe Nenin 23 të Ligjit nr.8331, datë 21/04/1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”,

URDHËROJ:

1. Ekzekutimin e vendimit penal nr.158, datë 27/01/2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me qëllim konfiskimin e pasurisë së palutshme dhe deklarimin e falsitetit të dokumentave të sekuestruara
2. Për ekzekutimin e këtij urdhëri, lidhur me konfiskimin dhe kalimin favor të shtetit të sendeve të sekuestruara, **Konkretisht:** Pasuria e paluajtshme me nr.13/8/1, vol.17, faqe 137, zk.8605, në emër të shtetasit Qirjako Lluka Gjikota, me sipërfaqje prej 2590 m², e vendosur nën masën e sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” me vendimin me nr.481 datë 18/02/2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ngarkohet Zyra Përmbare Vlorë
3. Për ekzekutimin e këtij urdhëri, lidhur me deklarimin e falsitetit të dokumentave të sekuestruara, duke urdhëruar ndalimin e qarkullimit të tyre dhe vendosjen e shenjës treguese “Dokument i falsifikuar”, **Konkretisht:** “Kartela e pasurisë së paluajtshme”, me nr.pasurie 13/8/1, vol.17, faqe 137, zk.8605, në emër të shtetasit Qirjako Lluka Gjikota, “Vërtetim pronësie”, Ipoteka Vlorë, më 01/04/1994, në emër të shtetasit Qirjako Gjikota, me nr.00005905, ZK.8605, në një fletë formati ½ a4, “Kontratë shitje” nr.14610.Rep, datë 22/03/1994, në një fletë formati A4, e cila në fund të fletës, ana e djathtë ka numrin 00005905, ngarkohet Drejtoria Vendore e Agjensisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë dhe Zyra e Noterisë Vlorë, Notere Jetmira Veraj.
4. Urdhëri t’i njoftohet Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.
5. Për zbatimin e urdhërit të njoftohet Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë./

PROKURORI

Xhemal SALIAJ